

KONKLUZAT E DAKORDUARA 2 KORRIK 2011

Liria e lëvizjes

1. Qytetarët (me vendbanim të pérhershëm) të të dyjave palëve duhet të kenë mundësi të udhëtojnë lirshëm brenda ose përmes territorit të njëra-tjetrës.
2. Secila palë do të zbatojë, sa më shpejt që është e zbatueshme në aspekt operativ, një sistem të kalimit të kufirit/kufirit administrativ të qytetarëve të palës tjetër me letërnjoftime;
3. Secila palë mund të zbatojë një sistem ku letërnjoftimet do të shoqërohen nga dokumenteⁱ me shkrim “hyrje-dalje” për personat nga pala tjetër të cilët dëshirojnë të kalojnë tranzit në një shtet të tretë.
4. Si zgjidhje kalimtare, secila palë do t'uа mundësojë qytetarëve të palës tjetër blerjen e polisave të sigurimit kufitar/kufitar administrativ. Nën përkujdesjen e BE, palët do të vazhdojnë të punojnë për një marrëveshje komerciale për sigurimin reciprok të automjeteve ashtu që të gjitha automjetet në të dy anët e kufirit/kufirit administrativ të janë të siguruar sa më shpejt që është e mundur.
5. Secila palë do të marrë të gjitha masat që t'uа mundësojë qytetarëve të palë tjetër të udhëtojnë lirshëm brenda dhe përmes territorit të njëra-tjetrës me patentshoferin e lëshuar nga autoritetet e veta.
6. Si masë kalimtare, autoritetet në Kosovë do të vazhdojnë vlefshmërinë e targave KS të automjeteve për një periudhë fillestare prej pesë vitesh në përfundim të së cilës çështja do të rishikohet nga të dyja palët (me lehtësimin e BE nëse kërkohet);
7. Të gjithë pronarët e automjeteve me vendbanim në Kosovë do të përdorin targat RKS ose KS (sipas pikës 6 më lartë). Ato do të lëshohen nga autoritetet përkatëse në Kosovë dhe do të shpërndehen me ndihmën e EULEX-it kudo që kërkohet. Secila palë do të bëjë përpjekje maksimale për implementuar si më lartë;
8. Si masë e përkohshme, autoritetet në Beograd do t'uа mundësojnë automjeteve nga Kosova që bartin targat KS të qarkullojnë lirshëm në dhe përmes territorit të saj;
9. Si masë kalimtare, për cilindo pronar automjetesh që dëshiron, do të vihen në dispozicion targa të përkohshme, në pikëkalimet kufitare/kufitare administrative.
10. Përkitazi me riatdhesimin dhe duke marrë parasysh obligimet e Prishtinës në këtë fushë, pikat e marrëveshjeve më lartë nuk do të krijojnë obligime për palën e Beogradit për të pranuar kërkесat për ripranim për personat me dokumente të Kosovës në kuadër të marrëveshjes ekzistuese për ripranim ndërmjet Serbisë dhe BE.
11. Një grup implemetues, i kryesuar nga BE, do të formohet për të siguruar që marrëveshjet e lartëcekura, së bashku me pikat tjera përcjellëse, të zbatohen sa më shpejt që është e mundur nga aspekti operativ, pika 7 do të zbatohet nga 1 nëntori 2011.

ⁱ Të gjitha dokumentet hyrje-dalje do të përbajnë gjuhë neutrale